




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT  
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT « ENFORCEMENT GROUP» SHPK

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1, Pall. e Shoqerise "GORA" Kati 3, Ap.14, Tirane Tel: 0672022667  
e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com



Nr.1123/7 Prot  
Nr.2084 Regj

Tiranë më, 19.08.2022

**URDHËR  
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE  
MBI KUOTAT E DEBITORIT**



**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit

**Për Dijeni:** Shoqëria "Muka 1741" shpk me Nipt L93623203L.  
**Adresa:** Elbasan, Rruga Metalurgji, godina nr 145, zone kadastrale 3965, nr pasurie 424

**Për dijeni:** Palës Kreditore Shoqëria "Kajo Dress Center" shpk me Nipt L82823002R  
**Adresa:** Poshnjë.

Unë Altin Latifi me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes me Nr.2084 Regj, bazuar në Urdhrin e ekzekutimit Nr.10462 Regj.Them., dt.05.07.2022 I Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**KONSTATOVA**

Se pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, është depozituar për Ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria "Kajo Dress Center" shpk me Nipt L82823002R, së bashku me Titullin Ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr.Serial 65960769, Nr.Fature 69, dt.13.12.2020, me vlerë 19,663.29 (Nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë njëzet e nëntë) Euro, me palë shitëse Shoqëria "Kajo Dress Center" shpk me Nipt L82823002R dhe palë blerëse Shoqëria "Muka 1741" shpk me Nipt L93623203L, për të cilën është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr.10462 Regj.Them., dt.05.07.2022 I Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë e objekt:

- Kreditor: Shoqëria "Kajo Dress Center" shpk me Nipt L82823002R
- Debitor: Shoqëria "Muka 1741" shpk me Nipt L93623203L
- Objekti: Pagim shume

**Me anë të këtij Urdhri ekzekutimi është vendosur :**

-Pranimi i kërkesës.

-Lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit për Titullin Ekzekutiv: Faturë Tatimore e Shitjes Nr.Serial 65960769, Nr.Fature 69, dt.13.12.2020, me vlerë 19,663.29 (Nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë njëzet e nëntë) Euro, me palë shitëse Shoqëria "Kajo Dress Center" shpk me Nipt L82823002R dhe palë blerëse Shoqëria "Muka 1741" shpk me Nipt L93623203L si edhe përlllogaritjen nga përmbaruesi gjyqësor të kamatave ligjore sipas nenit 5 të Ligjit Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare".

-Ngarohen shërbimet përmbarimore gjyqësore shtetërore ose private për vënien në ekzekutim të këtij urdhri.

-Shpenzimet gjyqësore, përmbarimore si dhe ato juridike për përfaqësim ligjor në ngarkim të debitorit.

**Për sa më sipër:**

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

**URDHËROJ:**

1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative në kuotat e debitorit Shoqëria "Muka 1741" shpk me Nipt L93623203L.

2.Kuotat e mësipërme do te qëndrojnë të sekuestruara për shumën 22,067 (njëzetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Euro dhe 247,030 (dyqind e dyzetë e shtatë mijë e tridhjetë) Lekë deri në një urdhër të dytë nga ana e zyrës sonë përmbarimore.

3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren sanksionet ligjore.



5-Kundër këtij Urdhri lejohet ankim në Gjykatë brenda 5 ditëve.

6.Pas dërgesës së këtij urdhri për vendosjen e sekuestros konservative mbi kuotat e debitorit të sipërcituar në shoqëritë e sipërcituara, kërkohet të na dërgohet pranë zyrës sonë statusi i kuotave pas kryerjes së bllokimit, brenda afatit ligjor.

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ALTIN LATIFI

